



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 156 Prot.

Tiranë, më 28.02.2017

V E N D I M

Nr. 43, datë 28/02/2017

"Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Dibër"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Dibër me shkresën nr.852/1, dt.17.11.2016, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.114, dt.16.10.2015 "*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Dibër*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 65 prot., datë 02.07.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit në institucionin, Këshilli i Qarkut Dibër*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është kryer inspektimi i përgjithshëm në Këshillin e Qarkut Dibër.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 114, datë 16.10.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Dibër*", në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Dibër, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër të revokojë aktin e emërimit nr.10, datë 02.05.2013 të punonjësës ***** në pozicionin "*specialiste finance*" në ish Drejtorinë e Financës dhe njësia përgjegjëse ose të emërojë nëpunës civil nga lista e pritjes, ose të shpallë të lirë këtë pozicion pune.

3. Ndryshimin e aktit administrativ të deklaramit të statusit të punësimit nr.115, datë 20.10.2014 të nëpunësit ***** , sipas përcaktimeve të nenit 67 pika 3 dhe 4 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përcaktuar se është nëpunës civil në periudhë prove.
4. Detyrimin e njësisë përgjegjëse të revokojë një ndër dy aktet e lirimit nga shërbimi civil, atë nr.29, datë 09.02.2015 që i përket nëpunësit civil ***** , ose atë nr.30, datë 09.02.2015 që i përket nëpunësit civil Burhan Shehu dhe bazuar në kompetencën ligjore të parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave të marrë vendimin përfundimtar të emërimit për një nga dy nëpunësit civil në pozicionin e paplotësuar të specialistit në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.
5. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit, në mënyrë nominale, për secilin nëpunës të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sipas parashikimeve të nenit 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi të DAMT-së dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).
6. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të riemërimit pas ristrukturimit, në mënyrë nominale për nëpunësit civilë: ***** me detyrë Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ***** me detyrë specialist jurist në sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ***** me detyrë Kryeinspektore e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës, ***** me detyrë specialist arkivi në sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, (pavarësisht se nuk i ka ndryshuar emërtesa dhe pozicioni i punës) sipas parashikimeve të nenit 50 pika 3 të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).
7. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosje individuale).
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet një afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Këshilli i Qarkut Dibër me shkresën nr.852/1, dt.17.11.2016, informon Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e Vendimit nr.114, dt.16.10.2015. Së

bashku me informacionin e dërguar është paraqitur dhe dokumentacioni shkresor, me anë të të cilit institucioni pretendon të provojë zbatimin e vendimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor të administruar nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, rezultoi se:

Së pari: Në zbatim të pikës 2 të vendimit të Komisionerit, Këshilli i Qarkut Dibër ka nxjerrë aktin nr.105, datë 28.12.2015 “Për revokim akti dhe lirim nga detyra” për punonjësen *****. Ndërprerja e marrëdhënies së punës për këtë punonjëse është bërë bazuar në shkronjën “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit(*punonjësja është me arsim të mesëm*), që në këtë rast është arsim i lartë.

Në kushtet kur punonjësja nuk plotësonte kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, veprim i parashikuar në pikën 6 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në këtë rast është zbatuar plotësisht rekomandimi i Komisionerit.

Së dyti: Në zbatim të rekomandimit të pikës 3 të vendimit, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr.115, dt.20.10.2014 duke e emëruar punonjësin ***** , pas përfundimit të procedurës së konkurimit “*nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*specialist audit*”.

Së treti: Në zbatim të pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse e kishte objektivisht të pamundur riemërimin e njërit prej punonjësve ***** , ose ***** në pozicionin e lirë të konstatuar në raportin përfundimtar, atë të specialistit në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Shkak për mospërmbushjen e këtij detyrimi është bërë fakti se pozicioni që kishte rezultuar i lirë nuk ekziston më, me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr.2, dt.28.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2016”.

Miratimi i këtij vendimi ka ardhur si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

Së katërti: Në zbatim të rekomandimit të pikës 5 dhe 6 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Dibër ka nxjerrë vendimet përfundimtare të emërimit për nëpunësit e mëposhtëm:

1. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 91, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*jurist*” në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Dibër.

2. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 89, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*kryeinspektor*” në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës, në Këshillin e Qarkut Dibër.
3. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 92, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*Drejtor*” në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Dibër.
4. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 90, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*specialist arkivi*” në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Dibër.
5. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 87, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*specialist*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Dibër.
6. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 86, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*përgjegjës sektori*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Dibër.
7. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 85, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*përgjegjëse sektori*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Dibër.
8. ***** është riemëruar me aktin administrativ nr. 88, datë 13.11.2015, pas ristrukturimit në pozicionin e punës “*Drejtor*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Dibër.

Së pesti: Në lidhje me zbatimin e pikës 7 të vendimit të Komisionerit, rezulton si vijon:

Përpara nxjerrjes së akteve individuale të riemërimit të nëpunësve civilë të Këshillit të Qarkut Dibër, njësia përgjegjëse në zbatim të rekomandimit të vendimit të Komisionerit dhe bazuar në përcaktimet e pikës 20, Kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, ka marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit.

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të inspektimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 114, datë 16.10.2015 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Dibër*”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Këshilli i Qarkut Dibër**,

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Dibër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar në tërësi rekomandimet e Vendimit nr. 114, datë 16.10.2015 ,“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Dibër”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Dibër, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA

Punoi

**SPECIALIST I KMSHC
Ilirjan OSMANLLIU**

Pranoi

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
Enkelejda HEBIBASI**